

REFERENCA E IDO : AL IDO-01-2024
VENDI I LËSHIMIT: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DATA E FILLIMIT TË VLEFSHMËRISË: 15.08.2024
DATA E MBARIMIT TË VLEFSHMËRISË: 14.08.2027
KODI I NOMENKLATURËS: 6406 20 90
PËRSHKRIMI I MALLRAVE : Shtresë e shollës së jashtme, e prerë në formën e shollës, masë unike nga dy filma pvc me ngjyra te ndryshme.

VENDI I ORIGJINËS DHE KUADRI LIGJOR: ORIGJINË PREFERENCIALE SHQIPTARE

Shtojca I e Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale pan-Euro-Mediterrane të Origjinës, ligji nr.1/2012;

Shtojcat A e rregullave kalimtare të origjinës, ligji nr. 98/2021 & 99/2021 datë 07.07.2021, ligji nr.101 datë 02.08.2021;

Neni 63 i Kodit Doganor, ligji nr. 102/2014.

JUSTIFIKIMI I VLERËSIMIT TË ORIGJINËS:

Shtresat e shollës së jashtme me kod tarifor “6406 20 90” prodhohen në Shqipëri nga bashkimi i dy filmave pvc-je me ngjyra të ndryshme të klasifikuar në kodin tarifor “3921 90 90” origjinues në Bashkimin Evropian.

Procesi i prodhimit është prerja në tranxhë, kalimi në presë dhe bashkimi i pjesëve nëpërmjet timbrimit me ngrohje duke marrë kështu formën e njëres palë të shtresës së jashtme të shollës së këpucës.

Ambalazhimi i tyre bëhet nëpër kuti kartoni. Proceset e kryera në Shqipëri janë më tej se ato minimale të nenit 6 “Punim ose përpunim i pamjaftueshëm” i Konventës Rajonale PEM dhe rregullave transitore.

Më tej, bazuar në nenin 3/1 “Konventa Rajonale PEM ” dhe 7/1 “Vendimi 1/2021 i rregullave transitore”; Shtresat e shollës së jashtme të klasifikuara në kodin tarifor “6406 20 90” të NK konsiderohen origjinuese në Shqipëri.

FOTO:

